

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
 AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2009

SESIONI I

(I DETYRUAR)

VARIANTI A

E martë, 2 qershor 2009

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme teknike profesionale (3+2) dhe 5-vjeçare

Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në prozë dhe në poezi.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e kërkesave të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10a	10b	11a	11b	12a
Pikët														
Kërkesa	12b	12c	13a	13b	13c	13d	14	15	16	17	18	19	20	21
Pikët														
Kërkesa	22a	22b	23	24a	24b	24c	25a	25b	25c					
Pikët														

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I**HEMINGUEJ****Plaku dhe deti
(fragment)**

Një zog i vogël po vinte drejt barkës nga veriu. Fluturonte shumë ulët mbi det dhe ish shumë i lodhur.

Zogu u ul te kiçi i barkës dhe po çlodhej atje. Pastaj erdhi rrotull mbi kokën e plakut dhe u ul të pushojë mbi litar ku ishte më mirë për të.

- Sa vjeç je?-e pyeti plaku zogun. - Ky është udhëtimi yt i parë? Zogu e shikonte tek po fliste. Ai ishte shumë i kapitur dhe nuk mundte bile as të provonte a ishte i shëndoshë litari, por vetëm lëkundej mbi të me këmbët delikate të kapura fort pas tij.

- Është i fortë - i tha plaku.- Është litar i fortë. Nuk duhej të lodheshe kaq shumë në një natë pa erë. Ah, ju zogjtë e sotshëm! Gjeraqinat, - mendoj, - po dalin në det të na takojnë. Por nuk i tha asgjë për to zogut, që sidoqoftë nuk do ta kuptonte dhe që për së shpejti do të mësonte vetë ç'janë gjeraqinat.

- Çlodhu mirë, mor zog i vogël, -i tha. - Pastaj fluturo dhe ndiq fatin tënd si çdo njeri apo shpend apo peshk.

Tani puhia ish e freskët dhe varka shkonte përpara me shpejtësi. Ai vështronte vetëm pjesën e përparme të peshkut dhe zuri të ketë shpresë. “Është marrëzi të humbasësh shpresën” mendoj. “Jo vetëm, por besoj se është mëkat. Mos mendo për mëkatin. Ke mjaft probleme të tjera përveç mëkatit. Të them të drejtën s’kuptoj shumë nga mëkatet.”

“Nuk i kuptoj dhe nuk jam i sigurt në i besoj. Mos bëra mëkat që vrava peshkun? Besoj se bëra mëkat, ndonëse këtë e bëra për të mos vdekur nga uria dhe për të ushqyer me të shumë njerëz. Në është kështu, atëherë çdo gjë është mëkat. Kot që të rrish e të mendosh se çfarë është dhe çfarë s’është mëkat. Tani është tepër vonë që të mendosh për gjëra të tilla; me mëkatet le të merren ata që paguhen për këtë punë. Ti ke lindur për të qenë peshkatar, ashtu siç ka qenë edhe i ati i Di Maxhios të madh.” Por i pëlqente të mendonte për të gjitha, midis të cilave ishte kredhur dhe, meqë s’kishte ç’të lexonte dhe s’kishte as radio, mendonte për shumë gjëra, duke përfshirë këtu edhe mëkatin. “Ti s’e vrave peshkun për t’ua shitur të tjerëve dhe për të jetuar” mendoj ai. “Ti e vrave nga kryelartësia dhe sepse je peshkatar. Ti e doje këtë peshk kur ishte i gjallë, edhe tani e do. Kur e do dikë, s’është mëkat në e vrafsh. Apo ndofta është një mëkat edhe më i madh?”

- Si shumë mendon, o plak,- tha me zë të lartë. “ Por ti e vrave me kënaqësi dentuson” mendoj. “Edhe ai, si ti, ushqehet me peshq. Ai nuk ha vetëm kërmat dhe nuk është vetëm një bark i pangopur si shumë peshkaqenë të tjerë. Ai është një kafshë e bukur dhe fisnike që s’di se ç’është frika”.

- Unë e vrava për t’u mbrojtur, - tha plaku me zë të lartë. - Dhe e vrava me zotësi të madhe.

Për pyetjet 1-7 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

1. Cili nga motivet e mëposhtme gjen pasqyrim në veprën *Plaku dhe deti*? **1 pikë**
- A) Fitorja dhe disfata
B) Frika dhe nënshtrimi
C) Pasioni dhe krimi
D) E drejta dhe përjetësia
2. Fjala *kryelartë* është: **1 pikë**
- A) e prejardhur
B) e përbërë
C) e përngjitur
D) e parme
3. Gjatë këtij fragmenti plaku filozofon ngaqë: **1 pikë**
- A) është filozof i mirëfilltë.
B) nuk mundet të mendojë më vetëm për peshkun.
C) ka frikë të sjellë ndërmend vdekjen.
D) kërkon të luftojë vetminë në mes të detit.
4. Stili i Heminguejit karakterizohet nga thjeshtësia, sepse: **1 pikë**
- A) temat e zgjedhura janë të vështira.
B) momentet e forta e kanë të vërtetën brenda tyre.
C) ngjarjet janë marrë nga historia e largët.
D) ngjarjet dhe personazhet janë thjesht krijim i fantazisë.
5. Në fragmentin e mësipërm paradoksi lidhet me: **1 pikë**
- A) vrasjen e peshkut, megjithëse plaku e do atë.
B) njeriun, që nuk e pëlqen detin, edhe pse është peshkatar.
C) mungesën e dëshirës për të jetuar edhe pse e sfidon jetën.
D) butësinë e shprehur ndaj zogut, edhe pse e urren atë.
6. Shprehja *peshkatar i plak* na lë të kuptojmë që: **1 pikë**
- A) plaku nuk është në gjendje t'u japë zgjidhje situatave.
B) plaku tashmë nuk ka më dëshirë për jetë.
C) lidhjet me detin janë të vjetra dhe plot përvojë.
D) plaku do ta braktisë detin përgjithmonë.
7. Një nga motivet e letërsisë së brezit të humbur, që del në këtë vepër, është: **1 pikë**
- A) lufta për ekzistencë.
B) urrejtja për natyrën.
C) nënshtrimi ndaj detit.
D) dashuria për femrën.

- 8.** Gjeni dy epitete me të cilët personazhi shpreh simpatinë e tij për dentuson. **2 pikë**
- a) epiteti 1: _____
- b) epiteti 2: _____
- 9.** Fragmenti përbëhet nga dy pjesë. Shkruani nga një fjali dykryegjymtyrëshe që jep thelbin e secilës prej tyre. **2 pikë**
- a) _____
- b) _____
- 10.** Gjatë leximit të fragmentit kuptojmë që plaku e ka vrarë peshkun. Jepni dy arsye që, sipas plakut, e detyrojnë atë të bëjë këtë zgjedhje, duke i ilustruar me shembuj.
- a) arsyeja 1: _____ **2 pikë**
- arsyeja 2: _____
- b) shembulli 1: _____ **2 pikë**
- shembulli 2: _____
- 11.** Meditimi i plakut paraqitet në dy mënyra. Identifikoni mënyrat dhe shpjegoni funksionin e tyre.
- a) mënyra 1: _____ **2 pikë**
- mënyra 2: _____
- b) funksioni: _____ **1 pikë**
- 12.** Shikoni fjalët dhe shprehjet me të cilat plaku i drejtohet zogut dhe më pas flet për peshkun. Shpjegoni një tipar të kësaj gjuhe për secilin rast, duke dhënë efektin që krijon te ju.
- a) gjuha kur i flet peshkut: _____ **1 pikë**
- _____
- b) gjuha kur i flet zogut: _____ **1 pikë**
- _____
- c) efekti: _____ **1 pikë**

PJESA II**Dritëro AGOLLI****Ëndrra e prerë
(fragment)**

Mos vdis, se pas shirave arën e mbushi bari,
Ka rënë në ullishtë mizë e ullirit.
Hardhia duhet spërkatur shpejt me gurkali
Dhe ende s'ka dalë nga plisi kërcelli i misrit.

Ne ëndërronim të bënim një anije,
Kurrkush s'e mendonte me ç'dru do ta ngrinim,
Kishim ndërmend ta ndërtonim me degë hardhie
Dhe vela t'i vinim.

Mos vdis, se dielli në oborr ka shtruar sofrën e madhe
Dhe presim të vijnë vajzat të gjitha,
Të gjitha ato që ti u thoshe “sorkadhe”
Kur grisnin fustanet në driza.

Mos vdis në dhomën e heshtur, i shtrirë.
Është turp kaq shpejt të rrish e të vdesësh!
Ne ëndërronim një vdekje pak më të mirë:
Duke vdekur, fytyrat tona t'i shihnim në pikën e vesës.

Për pyetjet 14-19 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

14. Kuptimi kryesor i kësaj poezie lidhet me:

1 pikë

- A) zhgënjimin e njeriut në idealin e tij.
- B) mallin dhe nostalgjinë për atdheun.
- C) mungesën e ëndrrave në jetë.
- D) udhëtimin më të bukur në kohë.

15. “Ëndrra e prerë” bën pjesë në llojin e poezisë:

1 pikë

- A) lirike
- B) epike
- C) dramatike
- D) epiko-lirike

16. Pjesëza “mos” ka kuptim:

1 pikë

- A) dëftues
- B) përfrues
- C) përforcues
- D) mohues

17. Folja në vargun “*mos vdis në dhomën i heshtur, i shtrirë*” është në mënyrën: **1 pikë**

- A) dëshirore
- B) urdhërore
- C) dëftore
- D) lidhore

18. Titulli i poezisë është ndërtuar mbi figurën e: **1 pikë**

- A) krahasimit
- B) paralelizmit
- C) epitetit metaforik
- D) personifikimit

19. E veçanta e gjuhës poetike të Agollit qëndron në: **1 pikë**

- A) mbështetjen në ligjërimin bisedor.
- B) luhatjen e fjalëve nga norma standarde.
- C) përdorimin e fjalëve të huaja.
- D) parapëlqimin vetëm të figurës së personifikimit.

20. Cili është detaji që lidh realitetin e strofës së parë me ëndrrën e strofës së dytë?

1 pikë

21. Në këtë poezi natyra jepet në lëvizje. Gjeni dy shembuj që e tregojnë këtë në strofën e parë.

2 pikë

a) _____

b) _____

22. Agolli ka disa tipare origjinale në stilin e tij poetik. Identifikoni dhe shpjegoni dy nga këto tipare që dalin në këtë poezi.

a) tipari 1: _____ **2 pikë**

tipari 2: _____

b) shpjegimi për të dy tiparet: **1 pikë**

23. A mendoni se kuptimi kryesor i kësaj poezie është dhënë që në titull?
Shpjegoni pse.

2 pikë

24. Në cilën vetë është shkruar kjo poezi? Gjeni një përemër dhe një folje që e tregon këtë.

a) veta: _____

1 pikë

b) përemri: _____

1 pikë

c) folja: _____

1 pikë

25. Ndaluni në strofën e tretë. Në ç'kohë e çojnë lexuesin këto vargje?
Si e kuptoni ju pranëvënien vajzë - sorkadhe?
Jepni dy elemente ngjashmërie midis tyre.

a) ëndrra dhe koha: _____

1 pikë

b) kuptimi i pranëvënies: _____

1 pikë

c) dy elementet: _____

2 pikë
